



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:185207

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05326946

AC.nr.4185/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit, gjyqtarët Arsim Hamzaj dhe Besnik Feka anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. K. nga fshati Prugovc, Komuna e Prishtinës, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Z. I., avokat në Prishtinë, Rruga “B. K.” Hyrja 69, Kati I, Nr.1, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1468/2006 të datës 09.09.2019 , në seancën e kolegjit e mbajtur me datën 14.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1468/2006 të datës 09.09.2019, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë C.nr.1468/2006 të datës 09.09.2019, ka vendosur: I.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses N. K. nga fshati P., Komuna e Prishtinës, DETYROHET e paditura “Sigal Uniqa Group Austria”, në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datën 28.08.2003, t`ia paguajë shumat e specifikuara si më poshtë: Dëmi jo material:

- kompensim në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej.....2,000.00 Euro.
- kompensimin në emër të frikës, shumën prej.....1,800.00 Euro.

- kompensim në emër të zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shumën prej .....800.00 Euro.

Dëmi material:

-kompensim në emër të mdihmës dhe përkujdesit të huaj, shumën prej.....70.00 Euro,

-kompensim në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej .....30.00 Euro,

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadsisë përtej shumave nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë, në emër të kompensimit për dhimbjet fizike, shumën prej 500.00 Euro, në emër të kompensimit për frikë, shumën prej 200.00 Euro, në emër të zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shumën prej 1,800.00 Euro, SI E PABAZUAR.

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve Sigal Uniqa Group Austria”, në Prishtinë, që paditëses për pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë t’i paguajë edhe kamatën, në lartësinë të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e afatizuara për një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 09.09.2019, e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 869.00 Euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura, Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plote të drejtës faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ta aprovoj si të bazuar ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar ashtu që ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar kërkesë padinë e paditëses, apo të njëjtin ta prish dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar nga paditësja edhe pse e njëjta me kohë është njoftuar me ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, si dhe shikimin, analizimin dhe vlerësimin shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja N. K. nga fshati P., Komuna Prishtinë, me datën 24.08.2006, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensim dëmit material dhe jo material, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, kërkesë kjo e precizuar me parashtrësën e datës 28.05.2019.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padsisë së paditëses, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor, dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.1468/2006 të datës 09.09.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës në aktgjykimin e ankimuar ka arsyetuar se: Me provat e administruara, gjykata ka gjetur se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 28.08.2003, në rrugën "Vëllezërit Fazliu", në Prishtinë. Aksidenti është shkaktuar kur ngasësi i automjetit O V duke mos ju përshtatur kushteve të rrugës (shpejtësisë) ka dalë prej anës së djathtë në të majtë dhe është ndeshur me kamionetën transportuese Mercedes L-809 me targa ....-KS-8., të cilin e ngiste B. D. nga Prishtina. Vetura e cila ishte shkaktare e këtij aksidenti kishte mbulesë të sigurimit tek e paditura. Si pasojë e këtij aksidenti lëndime të rënda trupore pëson paditësja N. K. në cilësinë e bashkudhëtares në automjetin "O. V.". Fakti se automjeti ka qenë i siguruar tek e paditura, nuk ka qenë rrethanë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, pra e paditura e ka pranuar bazën juridike të kërkesëpadisë sa i përket shkaktimit të aksidentit, por kontestuese ka qenë padia në raport me paditësen se e njëjta a ka qenë në veturë në cilësinë e pasagjeres në momentin kur është shkaktuar aksidenti i komunikacionit pasi që në raportin e policisë nuk është konstatuar se cilët persona kanë qenë të lënduar por vetëm është konstatuar se ka pasur lëndime të lehta.

Më tej ka shtuar se: Sa i përket kundërshtimit të paditurës se paditësja nuk është e evidentuar në raportin e policisë në cilësinë e pasagjeres në momentin kur është shkaktuar aksidenti i komunikacionit, gjykata ka vlerësuar se edhe pse nuk figuron në raportin e policisë N. K. si pasagjere prapë se prapë kjo është vërtetuar me raportin mjekësor të qendrës klinike emergjente në Prishtinë me numër protokollit 48473 i dt.28.08.2003, në të cilat raporte ka përputhje në datën e aksidentit dhe kohën kur është kontrolluar paditësja. Kjo është vërtetuar edhe me ekspertizën mjekësore të punuar me dt.20.03.2019, nga Dr. A. T. ortoped-traumatolog dhe Dr. S. B. - psikiatër, e cila ekspertizë është bazuar në raportin e qendrës klinike emergjente në Prishtinë me numër protokollit 48473 i dt.28.08.2003 si dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses me të cilën ekspertizë është konstatuar se në aksidentin e komunikacionit të datës 28.08.2003, paditësja N. K. ka pësuar lëndime trupore.

Më tej ka arsyetuar se: Gjykata pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat e administruara që i referohen natyrës dhe pasojave të lëndimeve të pësuar nga paditësja si pasojë e aksidentit e duke marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësorë lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jo material, gjykata vendosi në kuptim të nenit 200 të LMD-së. Me këtë rast, gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin-paditësen, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditëses. Pastaj, dhimbjet e pësuar fizike, intensitetin e dhimbjeve dhe kohëzgjatjen e tyre, intensitetin e frikës, kohëzgjatjen dhe si është manifestuar për paditësen, duke i marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, praktikën e mirë gjyqësore (që i referohet lartësisë së kompensimit), vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 277 të LMD-së së vitit 1978.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 449 dhe 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë, nuk është i përfshirë me të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe i përmbarueshëm dhe përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike e cila gjendje faktike i rezulton edhe gjykatës së Apelit, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Përgjegjësia e të paditurës është konstatuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Msc. Inxh. Dipl. S. B.M. Ekspert i komunikacionit e datës 24.04.2018, gjë që në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti i shkaktarit të aksidentit. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë me provat e administruara ka vërtetuar në mënyrë të plotë se në aksidentin e komunikacionit të datës 28.08.2003, lëndime trupore ka presuar paditësja e cila ishte pasagjere në automjetin O. V. me targa të regjistrimit 151 KS ...., gjë që vërtetohet nga raporti i emergjencës me nr. 48473 i datës 28.08.2003 e që ndërlihet edhe me kohen e aksidentit si dhe nga raporti i Policisë së Kosovës me nr. 13875 i datës 28.08.2003, në të cilën është konstatuar se në këtë aksident kishte të lënduar. Gjendjen faktike për dëmin jo material dhe material, për paditësen N. K., gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjekoligjor, përkatësisht ekspertit të ortopedisë - traumatologjis dhe ekspertit të psikiatrisë për të gjitha elementet e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë sepse nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve, dhe se kompensimi i dëmit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësore, prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e aprovuara për dëmin jo materiale dhe material janë në përputhje edhe me lëndimet e shkaktuara paditëses dhe të njëjtat paraqesin satisfaksion në raport me lëndimet e marra, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre si dhe kohën e nevojshme për shërimin, e të cilat janë konstatuar edhe nga ekspertizat e ekspertëve, Dr. A. T. Ortopedë-Traumatolog dhe Dr. S. B.. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim,

duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Gjykata e Apelit nuk i morri për bazë pretendimet e paditëses në lidhje me aplikim të gabuar të së drejtës materiale pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur është bazuar në nenin Neni 200 par. 1 të LMD-së, për kompensimin e dëmit material dhe jo material si dhe lartësinë e dëmit, i cili parasheh që *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm, si dhe për frikën, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*. Ndërsa në paragrafin 2 të po të njëjtit nen është paraparë që *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e sajë dhe me qëllimin shoqëror”*. Andaj, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditëses si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që kane pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit në raste të tilla.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me atë se paditësja nuk ka qenë bashkudhëtare në këtë aksident, por të njëjtat pretendime gjykata e Apelit nuk i morri për bazë, pasi që një fakt i tillë është vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë me prova konkrete dhe të mjaftueshme e që edhe për gjykatën e apelit është e vërtetuar në mënyrë të plotë sepse paditësja kishte pësuar lëndime trupore në këtë aksidente, pasi që këtë fakte e vërteton raporti mjekësor i emergjencës i cekur më lartë nga i cili mund të konstatohet se ekziston lidhja kauzale në mes të lëndimeve të pësuar të paditëses si dhe shkaktimit të aksidentit. Fakti pse paditësja nuk është evidentuar në Raportin e Policisë me nr. 13875 i datës 28.08.2003, nuk nënkupton se paditësja nuk ka qenë pjesëmarrëse në këtë aksident, pasi që në po të njëjtën ditë të aksidentit i fejuari i paditëses në Policin kurë është deklaruar për aksidentin ka potencuar se së bashku me mu në automjet ka qenë e fejuara ime e cila ka pësuar lëndime dhe është dërguar tek mjeku. Andaj, në rastin konkret nuk është përgjegjësi e paditëses që të mbikëqyrë policinë e në lidhje me raportin policore. Por paditësja me provat e propozuara në shqyrtim kryesorë ka vërtetuar se e njëjta lëndimet e konstatuara nga eksperti i Ortopedisë, i ka pësuar në aksidentin në fjalë.

Sa i përket pretendimeve të të paditurës në lidhje me dëmin material, gjykata e Apelit nuk i morri për bazë, pasi që vlerëson se dëmi material i gjykuar nga gjykata e shkallës së parë është real dhe i përputhet mendimit të ekspertit të Ortopedisë për këtë lojë të dëmit material. Gjykata e Apelit vlerëson se nuk nevojiten prova materiale për të vërtetuar se ky dëmi është shkaktuar sepse është

shumë e natyrshme se ndihmën e personit të tretë paditësja të ketë pranuar nga familjarët dhe se nuk mund të argumentohet me prova materiale e gjithashtu edhe ushqimi i përforcuar, pasi që është e natyrshme dhe e konstatuar nga ekspertët e cekur më lartë se paditësja kishte nevojë për ushqim të përforcuar. Andaj, një pretendim të tillë nga e paditura, nuk mund të merret për bazë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallë së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 277të LMD-së së vitit 1978.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat nenit 452.1 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AC.nr. 4185/2020, me datë 14.02.2024

Kryetar i kolegjit, Gjyqtari  
Besnik Bislimaj, d.v